



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources Directorate

Duke bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe nenit 4 të Ligjit Nr. 08/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe nenit 3 të Ligjit Nr. 08/L-156 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Rregulloren Nr.07/2023 për Rekrutim në FSK, Ministria e Mbrojtjes shpall:

K O N K U R S

Për rekrutimin e 60 ushtarëve aktiv
të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga radhët e komuniteteve jo shumicë

Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë të përfunduar shkollën e mesme;
- Të ketë aftësi të nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit;
- Të mos jetë i dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
- Të ketë figurë të pastër dhe të mos ketë probleme dëbimi nga shtetet tjera;
- Të jetë i moshës 18 - 25 vjeç në datën e aplikimit;
- Të ketë gjatësi trupore jo më pak se 165 cm për meshkuj dhe 160 cm për femra (kjo verifikohet gjatë fazës së testimit fizik);
- Të mos kenë tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrah nga pjesa e bicepsit e deri te gishtat e dorës duke përfshirë edhe pirsingun. (Në rast përzgjedhjeje, kandidatët janë të obliguar të bëjnë heqjen e tyre paraprakisht në afatin kohor deri në trajnimin bazik, në të kundërtën do të diskualifikohen).

Testimet për ushtar:

- Testi fizik;
- Testi i inteligjencies
- Testi i njohurive të përgjithshme:
- Intervista;
- Ekzaminimi shëndetësor;

Kalimi me sukses i testit paraprak është kusht për të drejtën e testimit në fazën vijuese, me përjashtim të testit të inteligjencës dhe testit të njohurive të përgjithshme, të cilët realizohen në të njëjtën kohë.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Diploma e shkollës së mesme /e nostrifikuar, (diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i nënshtrohen procesit të njohjes nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Ekstrakti i lindjes (jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Certifikata nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime, (dokumenti të jetë i nxjerrë brenda afatit të konkursit);
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës;
- Foto portret 4x4 për aplikim (elektronike);

- Dëshmi për kualifikime tjera (nëse posedon).
- Dokumenti i zotësisë së veprimit. (ky dokument kërkohet para se të fillojë trajnimi bazik).

Shënim: Kandidatët duhet të ofrojnë informata të sakta gjatë procesit të rekrutimit. Dhënia e informatave të rrejshme kurdo që zbulohet, gjatë procesit të rekrutimit apo gjatë shërbimit në FSK, rezulton me largim nga FSK-ja.

E drejta në ankesë

- Të drejtën e ankesës e ka çdo kandidatë pas marrjes së rezultateve të çdo faze të testimit përkatës;
- Rezultatet publikohen në Ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së dhe kandidatët e eliminuar kanë të drejtë ankesë brenda afatit dy (2)- ditor;
- Afati i ankesës rrjedh ditën pasuese pas publikimit të rezultatit;
- Ankesa dorëzohet përmes e-mallit në Zyrën e Rekrutimit;
- Bordi Përzgjedhës në afat prej 2 ditësh shqyrton dhe merr vendim për ankesën.
- Në rastet kur Bordi Përzgjedhës vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, e aprovon ankesën me të drejtë të kalimit në fazën tjetër ose ri-testimit;
- Kur Bordi Përzgjedhës vlerëson se ankesa është e pabazuar, ankesën e përcjellë te Bordi për Shqyrtim të ankesave, me sqarimet përkatëse, brenda afatit dy (2) ditor të punës nga pranimi i ankesës.

Konfirmimi i pranimit në FSK;

- Pranimi në FSK bazohet në gjendjen shëndetësore dhe fizike sipas nevojave e prioriteteve të FSK-së dhe pas përfundimit me sukses të procedurës së verifikimit të sigurisë, respektivisht pastërtisë së figurës, të përcaktuar me Rregulloren e Pastërtisë së Figurës për pjesëtarët e FSK-së të nxjerrë nga Ministri. Pranimi në Forcën e Sigurisë së Kosovës bëhet si rekrutë për kategorinë e ushtarëve dhe konfirmohet pas përfundimit të trajnimit bazik, gjatë së cilës kohë, kandidatët do të cilësohen si rekrutë (OR1).

Afati i aplikimit;

- Konkursi do të jetë i hapur prej 22 shtator 2025 deri më 21 tetor 2025, ora 23:59.

Si të aplikoni;

Aplikimi është online në adresën <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> si dhe njoftimi për shpalljen e konkursit mund të gjendet edhe në Web faqen e MM-së, <https://mod.rks-gov.net> . Kandidatët plotësojnë formularin e aplikimit online <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> dhe bashkëngjisin të gjitha dokumentet tjera të kërkuara nga ky formular. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në ditën e fundit të përmbylljes së konkursit. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr. tel. 038- 555584 5690 dhe 038- 555584 5691 nga ora 09:00 deri 15:00.

Ministria e Mbrojtjes mirëpret aplikacionet e femrave dhe meshkujve pa dallim nga të gjitha komunitetet jo shumicë.